



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 14.07.2025
Numër Protokolli: 4793/2025

A.nr.916/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.916/2025, të datës 20.05.2025, të parashtruar nga ankuesi I.N, kundër organit të punësimit/Agjencia e Statistikave të Kosovës, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 14.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.nr.916/2025, e datës 20.05.2025, e parashtruar nga ankuesi I.N.

A r s y e t i m

Nëpunësi Civil, I.N (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), me datë 20.05.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.916/2025 dhe numër protokolli:3160, kundër klasifikimit të vendimit të tij të punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 27.05.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Statistikave të Kosovës, ndërsa kjo e fundit, me datë 03.06.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e palejuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës të rezulton se ankuesi I.N, sipas Aktit të Emërimit me numër protokolli 04-052-1960 të datës 27.11.2018 mban pozitën punës “Zyrtar i Pasurisë”, në Agjencinë e Statistikave të Kosovës.

Tutje, nga shkresat e lëndës, rrjedhë se ankuesi me datë 05.05.2025, ka parashtruar kërkesë pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, me kërkesë për korrigjimin e koeficientit, përkatësisht klasifikimit të vendit të tij të punës nga Klasa Profesional 3 në Klasën Profesional 2, me koeficient të pagës 5.1, ndërsa nga shkresat e lëndës rezulton se organi i punësimit ka heshtur në kërkesën e tij të datës 26.03.2025, ashtu që i njëjti kundër heshtje administrative përmes e-mailit me datë 20.05.2025 ka parashtruar ankesë në Këshill.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës i’u referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenit 98 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, si dhe nenit 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtët ligj ku përcaktohet se: “1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ...”* e në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit e datës 20.05.2025 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e paraafatshme, pasi që ankuesi ende pa kaluar afati ligjor për përfundimin e procedurës administrative të iniciuar sipas kërkesës së datës 05.05.2025, dhe rrjedhimisht ende pa u përmbushur kriteri kohor lidhur me heshtjen administrative ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, mbi këtë bazë konstatimi, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankuesit është pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që për sa me sipër dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të parakohshme, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.916/2025

Atdhe GASHI

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Procesmbajtës

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit I.N;
- Menaxheres së Personelit në Agjencinë e Statistikave të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.